



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 28 janar 2021, në Mbledhjen e I (parë) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve, nr.52, dhe filloi në ora 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj.Albina Avdiu, kryesuese e Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Fevzi Jetullahu, përfaqësues i emergjencave civile; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: z. Isak Ejupi komandant i Stacionit të Policisë – Podujevë; z.Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Besfort Kruma, togër, përfaqësues i FSK-së; znj.Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe: znj.Valbona Blakqori, shëf i operativës në Stacionin e Policisë dhe z.Nexhip Jaha, përfaqësues i FSK-së.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, përshëndetje për të gjithëve, siç shihet jemi duke i respektuar masat në funksion të parandalimit të pandemisë Covid-19, atëherë mirë se keni ardhur në mbledhjen e I (parë) të KKS-së. Materialet për mbledhje konsideroj i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

nënvizoi, keni parë vendimin e përbërjes së re të KKS-së dhe ky vendim është rezultat i ndryshimeve pas procesit zgjedhor në Komunën e Podujevës dhe tash e tutje të vazhdojmë me këtë përbërje në punën tonë.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23 tetor 2020

U miratua njëzëri.

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht ia kalojme fjalën znj.Valbona Blakqori shefe e operativës në Stacionin e policisë në Podujevës e cila ne takimin e sotem është në zëvendësim të komandantit të Stacionit të Policisë z. Isak Ejupi.

znj.Valbona Blakqori, Përfaqësuese e Stacionit të Policisë, me që komandanti i Stacionit Policor në Podujevë është konfirmuar pozitiv me virusin COVID-19 unë jam zëvendësuese e tij derisa ai të kthehet. Sa i përket sigurisë në Komunën e Podujevës, përgjithësisht është e qetë pa tendenca për ndonjë destabilizim, ndërsa sa i përket takimit të fundit që është mbajtur me datën 23 tetor 2020 unë i'u kam referuar disa statistikave prej kësaj periudhe deri dje, kështu që Stacioni Policor në Podujevë ka trajtuar gjithsej 325 raste të natyrave të ndryshme prej tyre 13 raste armëmbajtje pa leje, që Policia i ka trajtuar këto raste dhe i ka proceduar nëpër gjykatat kompetente. Rastet me shqetësuese për ne, e që besoj edhe për komunitetin janë ngritja e rasteve të dhunës në familje, gjatë kësaj periudhë kohore kemi pasur 20 raste të raportuara ku viktimat kanë qenë kryesisht femra. Kemi ngritje edhe të veprave penale kundër pasurisë, vjedhje gjatë kësaj periudhe i kemi pasur 29 raste, ndërsa vjedhje e rendë 64 raste. Është me rendësi të potencohet se nuk kemi raste të vrasjeve dhe tentim vrasje, sepse janë raste që natyrisht ndikojnë edhe në siguri të përgjithshme. Ne veç se e kemi përpiluar raportin vjetor dhe krahasimin e raportit vjetor të vitit 2019 me atë të vitit 2020, mirëpo për shkak të pandemisë ne akoma nuk kemi planifikuar se kur do të bëhet prezantimi i këtij raporti, mirëpo akoma nuk kemi planifikuar se ku do të bëhet prezantimi i tij, në momentin që e planifikojmë do të jeni të informuar edhe ju edhe do të marr pjesë natyrisht edhe kuvendi komunal dhe akteret tjerë që kanë kontribuar në realizim të atij plani, pra do ta caktojmë një datë duke respektuar edhe rekomandimet e IKSHPK-së. Vlen të theksohet se vitin 2021 po e quaj që e kemi filluar me “këmbë të mbarë” për arsye se gjatë këtij angazhimi dy javorë ne kemi arritur ti godasim dy grupe të personave të ndryshëm të cilët kanë kryer vepra penale në Komunën e Podujevës, janë grupe të cilat përbehen prej moshës madhore por edhe të mitur. Këto dy grupe përbehen prej 4 personave të grupeve të ndryshme të cilët kanë kryer vepra penale në rajonin e përgjegjësisë së Stacionit Policor të Podujevës, ku janë gjetur edhe dëshmitë për të cilët ata kanë kryer vepra dhe u janë kthyer pronareve. Këta persona janë paraqitur para organeve kompetente, dy prej tyre i'u është dhënë edhe masa e paraburgimit në Qendrën e Paraburgimit, ndërsa dy të miturit janë në arrest shtëpiak, domethënë kjo ka qenë një periudhe 2 javore që kemi punuar me intensitet shumë të madh duke i përfshirë të gjitha kapacitetet operative në hetime, është një punë e mirë kështu që këtë desha edhe ta potencoj në mënyrë që të informohen edhe qytetaret e tjerë. Gjatë kësaj periudhë kohore kemi marr aktivitete të shumta duke filluar me plane operative por edhe me plane taktike, kryesisht i kemi dhënë prioritet menaxhimit të situatës me pandeminë Covid-19, jemi angazhuar në këtë kontest me qëllim që të bëjmë parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundje duke kontrolluar autobusit, kombi-busit, taksit, sepse në këto automjete kryesisht nuk po mbahet distanca dhe nuk po vendosen maskat, krahas kësaj javën e kaluar kemi shqiptuar për këta operator 20 gjopa për mos respektimin e masave, duke i përfshirë edhe udhëtarët që kanë qenë në autobus, kombi-bus dhe taksi. Kemi angazhuar edhe njësi në komunikacion dhe me të vërtet po mundohemi të menaxhojmë situatën mirëpo në këtë kontekst meqenëse janë edhe akterë të tjerë të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në komunitet, kërkoj që të gjithë ta luftojmë sepse është shqetësuese kjo situatë

andaj është e nevojshme që të gjithë ta ndihmojnë policinë duke filluar prej Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Inspektionit, Bashkësisë Islame etj. dhe mekanizma tjerë me ndikim, në funksion të vetëdijesimit të qytetarëve për mbajtjen maskave, respektimin e distancës distancës, në mënyrë që ta kemi situatën nën kontroll. Sikurse jeni në dijeni jemi në zonën e kuqe me të infektuar me Covid-19. Në kuadër të kësaj kemi bërë vizita tek personat që janë në vet izolim. Lista është bukur e gjatë, afro 300 dhe është pak problem për t'i vizituar të gjithë, problemi është që kur shkojmë t'i vizitojmë, shpesh ndodh që nuk del personi i cili është në liste me arsyetimin që është i sëmurë dhe ne pastaj nuk kemi të drejtë të hymë brenda dhe ta verifikojmë a gjendet personi aty apo jo, mirëpo qytetarët e kanë kuptuar rëndësinë e kësaj sëmundje, janë vetëdijesuar dhe po raportojnë në polici kudo që i shohin dhe që i njohin dhe ne pastaj marrin masa ligjore. Në kontekst duke ju referuar periudhës kur është mbajtur mbledhja e fundit e KKSB-së deri më tani janë shqiptuar gjithsej 1752 gjoba sa i përket Ligjit anti-covid, ndërsa sa i përket komunikacionit janë shqiptuar 1139 gjoba. Në komunikacion tanimë kemi angazhuar edhe planin operativ siguria në komunikacion për arsye se kemi një ngritje të aksidenteve, kemi caktuar 4 zyrtare policor të cilët janë duke punuar vazhdimisht, jemi duke i kontrolluar edhe pajisjet dimërore pasi që jemi në sezonin e dimrit, mirëpo është më shqetësuese se shumë pak ka qytetarë të pajisur me pajisjet dimërore, ndërsa veç se kemi hyrë në këtë periudhë, ku si pasojë kemi edhe aksidentet në komunikacion. Po ashtu rëndësi të veçantë i kemi dhënë edhe realizimit të urdhërësave ndaj personave me vepra më të rënda penale, për të cilat është dhënë verdikti përfundimtar nga ana e gjykatave. Gjatë kësaj periudhe një javore ne kemi arrestuar 22 persona të cilët edhe janë dërguar në vuajtje të dënimit. Jemi duke punuar me kapacitete të plota dhe gjithashtu jemi të angazhuar në zgjedhjet e parakohshme për 14 shkurt 2021, unë veç se jam në fazën përfundimtare të këtij planifikimi dhe po besoj që do të shkoj gjithçka në rregull. Kemi angazhuar njësitë inteligjente të cilat i kemi në nivel të stacionit në mënyrë që të merren informacione nëse ka ndonjë tendencë për prishje të rendit dhe qetësisë publike ose prishje të këtyre zgjidhjeve mirëpo deri më tani nuk kemi ndonjë informacion prej terrenit që do të këtë ndonjë destabilizim të situatës apo ndonjë prishje të këtyre zgjedhjeve të cilat do të mbahen me datën 14 shkurt 2021. Nuk hyra në detaje të secilit rast veç e veç për mos ta marr kohën sepse janë 325 raste dhe janë shumë për t'u raportuar mirëpo sikurse e theksova do të bëjmë prezantimin e raportit vjetor dhe aty do të cekem edhe rezultatet edhe ngecjet angazhimet dhe vërejtjet që i kemi, mirëpo jemi duke punuar me kapacitete të plota edhe pse kemi ngecje dhe probleme me çështje logjistike.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, nëse jeni dakord t'i dëgjojmë edhe informatat tjera e pastaj të hapim diskutimin lidhur me këto informata. Atëherë fjalën e ka z.Nexhip Jaha përfaqësues i FSK-së.

z.Nexhip Jaha, toger, përfaqësues i FSK-së, sa i përket çështjes së sigurisë në aspektin që ne e studiojmë konsiderohet e qetë dhe stabile ndërsa aktivitetet e FSK-së në Komunën e Podujevës nuk ka pasur për këtë periudhë kohore nuk ka pas ndonjë që vlen të theksohet, përveç disa materialeve mbrojtëse që i kemi dërguar në QKMF në Podujevë siç kemi bere edhe në të gjitha komunat tjera. Jemi në kontakt të vazhdueshëm me zyrtaret komunal sa i përket edhe situatës së fundit të krijuar nga vërshimet, fatmirësisht Komuna e Podujevës ka menaxhuar mirë sa i përket kësaj çështje dhe nuk ka pasur nevojë që të intervenoj niveli i 3-të i sigurisë gjë që kur intervenon niveli i 3-të i sigurisë i bije që dikush ka qenë në rrezik dhe është mirë që jeta e qytetarëve nuk ka qenë në rrezik, ne jemi gjithherë të gatshëm që të vijmë aty ku ka nevojë dhe çdoherë kur ka nevojë sigurisht me kapacitetet dhe mundësitë që kemi.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, e hap diskutimin. Meqenëse nuk ka ndonjë pyetje apo diskutim nga ana juaj, atëherë po e marr fjalën, tashmë dihet që para pak kohe kam pranuar detyrën e Kryetarit dhe mund të ju them se në këtë periudhë kohore afër dy muaj kemi një bashkëpunim të mirë me të gjitha institucionet relevante të sigurisë në veçanti me Policinë e Kosovës, kemi pasur kontakte të rregullta gjithashtu me KFOR-in. Me FSK-në ky është kontakti i parë. Mund të themi që përgjithësisht jemi të kënaqur me atë që ne e shohim prej këndit tonë si institucione komunale. Ka qenë periudha e para vitit të ri dhe disa ditë pas vitit të ri ku nga numri i madh i bashkatdhetarëve ishte një situatë ndoshta pak më e komplikuar sidomos në trafik, sepse normale nga numri i madh ajo stërngarkohet, sepse e dimë gjendjen çfarë është në rrugë dhe të ngarkesës së automjeteve. Ne i kemi marr disa veprime të cilat kemi menduar se janë në dobi të mërgimtareve tanë për të lehtësuar sado pak mundësinë e lëvizjes, filluam me hapjen e disa parkingjeve të reja brenda përbrenda qytetit por që kushtet atmosferike e pamundësuan për të vazhduar më tutje, projekti do të vazhdohet tani pasi të përmirësohen kushtet atmosferike. Kemi ngritur kapacitetet tona në përgjithësi. Ndoshta ajo që vërehet, sikurse e theksoi edhe zyrtarja nga Policia e Kosovës duket mungesa e stafit të mjaftueshëm Kam biseduar edhe me Komandantin e Stacionit Policor në Podujevë, e normale që kam shpreh shqetësimet, por e kam parasysh faktin që nuk janë kapacitetet e plota me të cilat punoni pavarësisht faktit që është marr një vendim i mirë, i ngritjes së nivelit të Stacionit Policor. Ndoshta në këtë aspekt nuk jam idhëtar i asaj që njerëzit me u sanksionua por që duhet ta mbajmë pak një rend për shkak të këtyre parkingjeve vend e pa vend sidomos dhe këtu ndoshta mendoj që në të ardhmen duhet me pas parasysh faktin për të rritur kapacitetet, për të pasur sa më shumë lëvizje të policëve sidomos brenda përbrenda qytetit, jo me makina por me patrullime në këmbë, pra kjo vërehet si mungesë. Në bisedim edhe me komandantin e Stacionit Policor në Podujevë jam i informuar që ka mungesë por shpresoj që me kohë do të bëhet një zgjedhje, sepse e di që sa i përket terrenit është më i madhi në nivel vendi dhe keni edhe përgjegjësit tjera që u takon. Do ishte mirë që në këtë aspekt të ndërmerret diçka, jo që ti sanksionojmë njerëzit por për të bërë përpjekje në aspektin e vetëdijesimit të tyre. Unë shoh problemin e makinave në parkingun para komune ku në të dy anët vendosen dhe e bllokojnë komunikacionin dhe problemi tjetër që tashmë jemi dëshmitarë të gjithë, e që duhet të merremi si institucion, që fatkeqësisht nuk kemi mund ta bëjmë një zgjidhje dhe është kompetencë e jona, është çështja e numrit të madh të qeneve endacak që kemi si në qytet ashtu edhe në zonat rurale. E dimë që janë disa pengesa ligjore por Drejtori i Shërbimeve Publike veç se ka filluar diçka për zgjedhjes e kësaj çështje. Shumica e atyre qenve nuk janë të rrezikshëm megjithatë po ka momente që po i frikësojnë njerëzit. Pra kjo do të zgjidhet nga z.Fevzi Jetullahu drejtor i DSHPMSh- ku do të mundohemi që të ketë një numër të tyre sa më të vogël e sidomos në qytet por edhe në fshatra sepse kemi ankesa nga qytetarët që i kanë sulmuar por njëkohësisht paraqesin edhe frikë për njerëzit. Një çështje që po ashtu ka qenë shumë brengosëse së pari për mua si Kryetar komune por besoj edhe për të gjithë ju është prezenca e një numri të madh të sëmureve mendor të cilët po i kemi çdo ditë në rrugët tona. Dy prej të sëmureve mendor që janë më shumë të frekuentuar dhe më është premtuar se shumë shpejt do të vendosen në institucionin shëndetësor mendor, sepse sikur po e shihni përveç tyre po grumbullohen edhe një numër të madh të qenve pranë tyre pasi që edhe po i ushqejnë, e të cilët po paraqesin edhe rrezik për qytetarët. Besoj së shpejti ka për tu zgjedhur ky problem dhe kjo ka për të qenë një lehtësim. Ka edhe disa të tjerë të sëmure mendorë por çështja e vrazhdësisë nuk është sa e këtyre. Këto ishin ato që desha t'i potencoj dhe besoj që në këtë aspekt do të gjejmë përkrahje edhe nga policia duke marr parasysh ngritjen e nivelit të stacionit, me që rast do të ketë edhe personel shtesë.

znj.Valbona Blakqori, Përfaqësuese e Stacionit të Policisë, çështja e komunikacionit ka qenë dhe është sfidë gjithmonë për Policinë e Kosovës. Sigurisht jeni ne dijeni që rrugët janë të ngushta, pastaj ka mungesë të parkingjeve publike dhe kjo paraqet problem, duke mos përjashtuar edhe mungesën e vetëdijesimit të qytetarëve sepse ne nuk mund të kujdesemi që secili qytetarë të ketë nga një polic. E shoh edhe nga provoja ime deri sa unë përfundoj kontrollimin për parkim prej fillimit të sheshit deri tek objekti i komunës së vjetër prapë janë të mbushura pjesa nga kam kontrolluar, domethënë është problem për çka ne vazhdimisht edhe në fushata sensibilizuese jemi munduar t'i vetëdijesojm qytetarët për respektimin e këmbësorit, ligjit dhe të Policisë dhe jemi duke punuar në atë drejtim. Sikurse jeni informuar nga komandanti i stacionit, si Stacion kemi kaluar prej kategorisë 'B' në kategorinë 'A' që do të thotë është shtuar numri i zyrtareve policorë, mirëpo deri më tani ne nuk kemi marr policë shtesë domethënë është rregulluar struktura por nuk është plotësuar. Ajo çka është bërë i kemi marrë 4 togerë, tani kemi tani 4 ndërrime me 4 togerë që me të vërtetë kanë qenë të mirëpritur prej anës tonë sepse kemi pasur mungesë të eproreve. Në këtë kontekst ne do të angazhohemi më shumë për atë arsye edhe kam planifikuar plane konkrete në komunikacion por normale që na nevojitet ndihma e të gjithë të tjerëve kryesisht edhe e qytetarëve. Sa i përket çështjes së qeneve endacak mund të potencoj që kemi vazhdimisht thirrje prej qytetarëve dhe ato thirrje i përcjellim pastaj në dikasterin përkatës në nivel komunal mirëpo ka thirrje të shumta jo vetëm në qytet mirëpo edhe nëpër fshatra,sepse tashmë paraqesin rrezik, ngase edhe kushtet atmosferike janë të atilla që këta qenë endacak nuk kanë ku të ushqehen dhe i sulmojnë qytetarët, e në këtë rast më të rrezikuarit janë nxënësit por akoma fatmirësisht nuk na ka ndodh mirëpo nuk përjashtohet mundësia. Kjo është çështje që duhet të rregullohet në nivel qendrorë e unë e kuptoj që jemi në komunikim të vazhdueshëm dhe nuk janë mundësitë që të rregullohen në nivel komunal por që kisha kërkuar që takimet që i keni ju edhe me nivel qendrorë të paraqitet si problem madhor sepse është problem madhor. Sa i përket personave të sëmurë mendor apo si i quajmë persona me aftësi të kufizuar, me të vërtetë nëse një çështje e tillë ndodh unë personalisht por edhe të gjithë qyteti duhet të jenë të lumtur dhe duhet të jenë krenar sepse këta persona qe 20 vite qëndrojnë në rrugë keqtrajtohen fizikisht, psikikisht, madje njëra prej tyre që është femër keqtrajtohet edhe seksualisht nga persona të pa ndërgjegjshëm, se çka ka bere policia në këtë drejtim unë personalisht sepse jam pjesë e tyre dhe e familjes time, qe 20 vite kam trokitur nëpër institucione të ndryshme, kam plotësuar gjithçka çka ata kanë kërkuar, qoftë dokumentacion por asnjëherë nuk është ndërmarr asgjë mirëpo ata janë pasqyra e komunës. Kam kërkuar edhe prej Qendrës për Punë Sociale (QPS) dhe të gjithëve me u kyç dhe me i larguar prej rruge, ju i shihni edhe kushtet atmosferike se si janë, ne brenda tani dhe kemi të ftoftë e lëre më ata që gjumin e bëjnë rrugëve, fundi i fundit janë qenje njerëzore, sëmundja mundet me i ndodh gjithsecilit, familja i ka kryer të gjitha obligimet që i takojnë por a mundet të mbahet nga një familje normale, nuk mundet sepse paraqet rrezik, ata i sulmojnë edhe njerëzit, unë kam pasur rast që kanë sulmuar gruan shtatzënë në qytet, kam pasur rast që i kanë sulmuar fëmijët duke shkuar nëpër shkolla, bartin thika janë të rrezikshëm. Kur kanë qenë të dhunshëm dhe është kërkuar për t'i dërguar për ndonjë injeksion në Emergjencë ne kemi pasur problem sepse jemi sulmuar prej tyre. Nëse ndërmerret një veprim i tillë prej Kuvendit Komunal me të vërtete është shumë mire unë ndihem shumë krenare për punën dhe angazhimin e juaj që e keni bërë sepse thash posaçërisht ata dy posa të hysh në komune janë pasqyra e komunës dhe e atij institucionit që qeverisë dhe që na bije të gjithë ne si institucione Polici, Komunë e QPS sepse me të vërtetë duhet të largohen prej rruge kështu që për neve do të jetë lehtësim edhe si familje por edhe komplet si polici edhe si qytetarë, sepse unë nuk e anashkaloj ndihmën e qytetareve, të gjithë që

i kanë ndihmuar dhe në çfarëdo forme mirëpo ka pasur edhe keqpërdorim të shumë të tyre, kështu që me të vërtetë bëhet një punë e mirë dhe çdo mbështetje që nevojitet prej policisë qoftë me personel apo transporti i tyre jemi në dispozicion. Çka është shqetësuese për t'u cekë, atyre u është aprovuar e posaçërisht Flories kërkesa për t'u dërguar në Shtëpinë e Shëndetit Mendor në Shtime afro 2 vite, domethënë është plotësuar dokumentacioni, është aprovuar kërkesa dhe nuk është vendosur. Përmes telefoni na përgjigjen se nuk vend, por si ka mundësi që të aprovohet një kërkesë e nuk u'a caktojnë vendin e vendosjes domethënë tani ne duhet të presim të vdes dikush apo të mos vdes apo çka do që ndodh edhe sa vite duhet të presin të sëmuret e tillë për të tu liruar një vend kështu që me të vërtetë unë po e them publikisht është një neglizhencë e institucioneve që nuk kanë marr parasysh këto dy raste, të sëmurëve mendor "Gzimit" edhe të "Flories" kështu që unë ju përgëzoj për angazhimin dhe iniciativën që e keni marr sepse që 20 vite nuk kam gjetur përkrahje dhe mbështetje në nivel komunal për t'i larguar këta persona nga rrugët.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, javën e shkuar kam pasur një takim me zyrtarët e shëndetit mendor në nivel të rajonit dhe më është premtuar. Kam marr obligimet e mia të cilat janë në nivel komune ose si institucion dhe jam i gatshëm që nëse ka nevojë të participojm ose të bëjmë pagesë vetëm që ti largojmë prej rruge sepse ka qenë zotim i imi edhe para se me ardh në këtë pozitë, e që nuk ka qenë problematikë politike por problematikë e një pasqyre të keqe që japin sidomos këta dy persona dhe fatkeqësisht a janë marr apo jo nuk e di por në fund të fundit e kemi edhe obligim moral t'i largojmë prej rruge në këto kushte të rënda çfarë janë kështu që unë kam besim të plotë që kjo çështje të zgjidhet. Nëse nuk ka dikush diçka të shtoj për këtë pikë të rendit të ditës kalojmë në pikën e radhës.

3. Ngritja e grupeve punuese për:

-Përgatitjen e propozimit të Planit të punës për vitin 2021

-Përgatitjen e Informatës për aktivitetet e KKSB-së në vitin 2020

Kryetari pas debatit dhe aprovimit të propozimeve konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2021 dhe për përgatitjen e Informatës për punën e KKSB për 2020, në përbërje:

- 1.Avni Fetahu
- 2.Isak Ejupi
- 3.Fevzi Jetullahu
- 4.Nexhip Jaha
- 5.Albina Avdiu
- 6.Mensur Hoti
- 7.Qefser Behrami

4. Të ndryshme

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, nëse e vlerësoni edhe ju desha ta jap një informacion të shkurtër, një raport prej komisionit të vlerësimeve të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të cilat ndodhën si rezultat i reshjeve të mëdha në komunën tonë.

Ne kemi formuar një shtab të krizës dhe një komision për vlerësimin e dëmeve dhe janë ndërmarr veprime nga të njëjtat. Dje mora informacion që janë disa ekonomi familjare që nuk

janë trajtuar dhe kanë kërkuar një kohë shtesë për t'i trajtuar. Vlerësimi i parë i dëmit financiar është mbi 585.871.52 €, janë dëmtuar 31 fermerë, kulturat e tyre bujqësore dhe 29 ekonomi familjare. Problemin e vërshimeve e kishim edhe pardje, prapë kemi qene tërë ditën me Drejtorin e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe zyrtarët përgjegjës si dhe të zjarrfikësit dhe si rezultat është menaxhuar situata. Dëme ka prapë, është sepse shumë prej këtyre arterieve që kanë qenë dhe kanaleve të ndryshme tërheqëse të ujit janë mbyllur si pasojë e një menaxhimi jo të mirë të situatës më herët, ka mbi këto kanale kryesore edhe objekte të ndërtuara disa katesh e të cilat objekte ne nuk mundemi me i rrënuar tash mbas 20 viteve sepse nuk është dashur me kohë të ndërtohen por ja që e kanë përkeqësua punën bukur shumë gjendjen.

Edhe një informacion të shkurtër për situatën e Covid-19, këto dite kemi pasur rritje të numrit të infektuarve, duket që numri i madh i bashkatdhetarëve pak a shumë e ka ngrit pak numrin, jemi në zonën e kuqe dhe kemi kufizim të lëvizjes prej orës 21:30 deri në orën 05:00 të mëngjesit, gastronomia mund të punoj vetëm deri në ora 21:00 në mbrëmje, i kemi aktualisht 553 raste aktive, 41 raste janë me fatalitet dhe 2279 raste të shëruar. Megjithatë është një shifër e lartë në raport me atë para 10 dite, që ra numri bukur shumë ku kaluam prej zonës së kuqe në zonën e verdhë, kjo është një informatë që ta keni si një informacion dhe çështja tjetër, e konfirmuar nga zyrtarët të cilët po na ndihmojnë në punë, u njoftoj që z.Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb, dhe znj.Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, e që në realitet nuk e di se si ka hyrë këtu, por që unë nuk e di në qfarë forme ka hyre por kjo është anëtare e kryesisë së një subjekti politik, ndoshta edhe në këshillin e përgjithshëm dhe nuk është përfaqësuese e OJQ-ve, të dy këta i kane plotësuar kushtet ligjore që mos të jenë më pjesë e këtij këshilli për shkak të mungesave në takimet e këshillit dhe në këtë rast propozojmë që të bëhet ftesa e subjekteve përkatëse, komunitetit serb dhe OJQ-ve që t'i nominojnë përfaqësuesit e tyre në mënyrë që të plotësojmë Këshillin për Siguri në Bashkësi.

z.Liman Zeqiri, z.Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb momentalisht nuk jeton në Kosovë, jeton në Medvegje dhe ka një moshë bukur të shtyrë. Ka munguar rregullisht sepse edhe me shëndet nuk qëndron mire, ndoshta është edhe arsyeja që ajo lagjja “Sekiraqa” është boshatisur dhe asnjë banor nuk qëndron aty të nacionalitetit serb, de facto ata i kanë pronat aty munden me ardh verës kur është sezoni por në situatat dhe rrethanat që tani jemi momentalisht nuk ekziston asnjë banorë dhe ka një vit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, unë besoj që janë plotësuar të gjitha kushtet që Këshilli të të plotësohet me dy anëtarë të ri dhe mendoj që edhe ju jeni dakord që këto të përcillen në kuvend dhe ti ndryshojmë.

Konstatim: anëtarët e Këshillit unanimisht përkrahën qëndrimin e Kryetarit të Komunës që t'u bëhet ftesë subjekteve përkatëse(komunitetit serb dhe OJQ-ve) për të nominuar përfaqësuesit e tyre për plotësimin e KKS-së në Kuvendin e Komunës.

z.Liman Zeqiri, dëshiroj që nga drejtori i Arsimit z.Avni Fetahu për procesin e mbarëvajtjes së mësimi pasi dihet që kjo pandemia që e ceke është në rritje, vetëm në pika të shkurtra se si është fillimi i vitit, mbarëvajtja e procesit mësimor, kushtet dhe rrethanat pasi që e dimë se si janë mbajtur online mësimet dhe kanë humbur edhe orët mësimore por është të dimë procesi i arsimit si qëndron.

z.Avni Fetahu, procesi i arsimit ka filluar pa ndonjë vështirësi të madhe, prej 41 shkollave 36 i kemi në planin “A”, në planin “B” i kemi 4 shkolla që kryesisht janë të mesme për shkak të

numrit të madh të nxënësve. Deri dje e kemi pasur me planin “C” që nënkupton mësimi online shkollën në fshatin Lluge ku nga dje ka filluar edhe mësimi brenda shkollës dhe është kthyer në planin “A” përndryshe e kemi një familje të riatdhesuar në kuadër të shkollës “Ali Ajeti” ku janë 4 anëtarë e një familje dhe janë kthyer dhe janë duke u marr ekipa përcjellëse për këtë çështje, sa i përket çështjes së pandemisë që është e kemi numrin e mësimdhënësve që është që nga fillim viti kur edhe ka filluar me 107 mësimdhënës që kanë qenë pozitiv me covid-19, 181 mësimdhënës kanë qenë negativ e aktualisht i kemi vetëm 7 mësimdhënës që janë aktiv me covid-19. Ndërsa tek nxënësit kemi pasur një numër prej 88 nxënës që kanë qenë pozitiv me virus, 218 kanë qenë negativ e aktualisht i kemi vetëm 8 nxënës që janë pozitiv me covid-19. Këto janë në pika të shkurtra, përndryshe unë desha të ndërlihem, por mendoja kur të hartojmë planin e punës për vitin 2021. Ne kemi pasur vetëm një takim me zyrtaret e policisë që nuk janë me uniform dhe që kontrollojnë neper shkolla e që kanë kryer një punë shumë të mirë ajo që na duhet ndoshta në të ardhmen me rrit edhe një numër të tyre që me qenë në të njëjtën kohë në dy shkolla edhe tek gjimnazi “Aleksandër Xhuvani, edhe tek teknika “ Fan S. Noli” sepse po ndodh nganjëherë që kur janë në ekonomi ata merret vesh që janë në ekonomi dhe zhvillohen disa aktivitete po kur janë në të njëjtën kohë besoj që e menaxhojnë situatën më mirë. Në të njëjtën kohë deri me datën 10 shkurt do të keni një data bazë të të dhënave të cilën kemi menduar edhe me kryetarin të shohim anën ligjore a u lejohet që ta keni edhe ju atë data bazë të të dhënave si polici në mënyrë që rastet që kanë qenë të nxënësve që janë shqiptuar masat disiplinore ti keni edhe ju në mënyrë që kur të veproni në gjykatë me qenë më e argumentuar e mos të kthehen nxënësit pas shqiptimit të masës sikurse hero po kthehen në shkollë dhe po bëjnë probleme. Kur e keni data bazën e të dhënave që kujdestari i klasës apo drejtori ka shqiptuar masa, atëherë edhe ju e keni më të lehtë kur ta drejtoni rastin në gjykatë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, nëse nuk keni diçka për të shtuar, e përmbyll takimin, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/01-0005058/21
Podujevë, 28 janar 2021**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**